

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

**Kursi:**

BAZAT E RETORIKËS

**Niveli dhe lloji i kursit:** Bachelor, me zgjedhje

**Viti i studimeve dhe semestri:** Viti i tretë, semestri V

**Numri i orëve në javë:** 2+2

**Vlera në kredi ECTS:** 4

Prof. asoc. dr. Kujtim Shala

**Qëllimet e kursit**

Kursi **Bazat e retorikës** ka për qëllim që studentëve t'ua bëjë të njohura parimet e ndërtimit të ligjëratës, duke patur parasysh gjetjen edhe sistemimin e informacionit (të dhënave, fakteve) në një rend, provimin, si dhe përçimin e tyre në diskurse të zgjedhura, në përputhje me objektin (lëndën) e ligjëratës.

Meqë zhvillohet në Degën e Letërsisë Shqipe, ky kurs, përpos që jep informacionin themelor të fushës së teorisë së ligjëratës, përqendrohet te retorika e letërsisë.

**Rezultatet e pritura**

**Bazat e retorikës** bën të njohura parimet themelore të strukturimit e të funksionimit të komunikimit përgjithësisht e të komunikimit letrar në veçanti.

Edhe pse Retorika sot shtrihet përtej fushës së parë/të vjetër dhe prek të gjitha trajtat e komunikimit, nga komunikimi verbal tek ai vizuel e verbalo-vizuel (p.sh. marketingu), ky kurs mundëson njohjen dhe aplikimin e parimeve retorike te diskurset letrare.

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- Të dallojë strukturat retorike themelore, të vlefshme për diskurset retorike.
- Të dallojë strukturat retorike të diskurseve letrare.
- Të arrijë të analizojë e të përcaktojë funksionet retorike të strukturave retorike të tekstit letrar, nga figura te mbarështrimi.
- Duke pasur për bazë analizën e strukturave retorike, të interpretojë tekstet në planin e strukturës e të ideve.

**Metodologjia e mësimdhënies**

Leksione, punë individuale, diskutime

## **Literatura bazë**

1. Rolan Bart: **Aventura semiologjike** (pjesa *Retorika e vjetër*), Prishtinë, 1987; Pejë, 2008
2. Kujtim M. Shala: **Pro/Classica** (kapitulli *Retorika klasike*), Prishtinë, 2005
3. Tekste për ilustrim dhe analizë
4. Leksione të shkruara

## **PLANI / PROGRAMI**

*Java e parë:* Hyrje në retorikë

*Java e dytë:* Argumentet dhe stili

*Java e tretë:* Retorika dhe studimi i ligjëritimit

*Java e katërt:* Historia e retorikës - hyrje

*Java e pestë:* Retorika antike greke

*Java e gjashtë:* Retorika romake

*Java e shtatë:* Retorika e Mesjetës

*Java e tetë:* Nga retorika jezuite te retorika e përgjithshme (shek. XX)

**(Vlerësimi gjysëmsemestral)**

*Java e nëntë:* Retorika bashkëkohëse

*Java e dhjetë:* Arti retorik

*Java e njëmbëdhjetë:* Gjeturia

*Java e dymbëdhjetë:* Mbarështrimi / Elokuenca

*Java e trembëdhjetë:* Retorika e letërsisë

*Java e katërbëdhjetë:* Retorika e poezisë: struktura dhe figura

*Java e pesëmbëdhjetë:* Retorika e prozës: struktura dhe diskursi